



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ROMINA SH. MELI
ADRESA NR.9, HAXHI HYSEN
DALLIU, PALL. ALVO
CONSTRUCTION
TEL: 698609109



KONTRATË SHITJE PASURIE E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1711

Nr. koleksioni: 647

Tirane më 06/07/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2020052570052210490



**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "PRO-NARDI" SH.P.K)**

Sot, më datë 06/07.2020 (dymijë e njëzet), para meje Notere ROMINA SH. MELI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, HAXHI HYSEN DALLIU, PALL. prane Prokurorisë së Rrethit Tirane, kati i pare, u paraqit personalisht:

SHITES:

Latif Hoxha, atësia Hazis, amësia Ajshe, shtetas Shqiptar, lindur në Sorice, Diber dhe banues në TIRANE, me adresë 1047 PASKUQAN FRANKO GJINI 03940074 12 1, lindur më 05/02/1974, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 026316322 dhe nr. personal H40205099Q, në cilësinë e ortakut të shoqërisë "**PRO-NARDI**" shpk, shoqëri e themeluar më 17.09.2019 dhe e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 25.09.2019 me NIPT L97125401K.

BLERES:

Lonard Hoxha, atësia Latif, amësia Majlinda, shtetas Shqiptar, lindur në Paskuqan, Tiranë dhe banues në TIRANE, me adresë 1047 PASKUQAN FRANKO GJINI 03940074 12 1, lindur më 22/03/2002, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036037708 dhe nr. personal K20322072M.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "PRO-NARDI" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

DUKE PATUR PARASYSH SE :

- i. Blerësi është në procesin e blerjes së kuotës së shoqërisë me emërtim tregtar "**PRO-NARDI**" shpk., një Shoqëri e organizuar rregullisht dhe themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë më datë 25.09.2019 me Numër identifikimi të personit të tatueshëm (NIPT) L97125401K, me seli në Dibër, Shupenzë, Njesia Administrative Shupenzë, Banesa nr.1, këtë e tutje quajtur "Shoqëria".
- ii. Shitësi është zotërues dhe posedues te padiskutueshëm të 100% kapitalit të shoqërisë (këtë e tutje e quajtur kuota).
- iii. Shoqëria ka një kapital prej njëqind mijë (100.000) Lekë, të ndarë në një kuotë të regjistruara dhe me vlerë nominale të kuotës prej 1 (një) Lekë, e cila është nënshkruar dhe derdhur rregullisht dhe në mënyrë të vlefshme.

Me vendimin e datës 06.07.2020 të Ortakut të shoqërisë është vendosur shitja e kuotave në masën 100% të tyre nga ana e Ortakut të Shoqërisë **Z.Latif Hoxha**, në masën 100% dhe blerja e tyre nga **z. Lonard Hoxha** në masën 100%.



Shitja në masën prej 100% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë “**PRO-NARDI**” shpk. sjell humbjen e të drejtës së pronësisë mbi kuotat e kapitalit themeltar të ortakut të shoqërisë **Z. Latif Hoxha**, në masën 100%, si rrjedhojë e këtij transaksioni shitje kuotash, të shprehur në vendimin e Ortakut, datë 06.07.2020.

Shitësi **Z. Latif Hoxha** është plotësisht dakord të shesi me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë përkatësisht në masën prej 100% të kuotave që ai zotëron në shoqërinë “**PRO-NARDI**” shpk. Kjo shitje kuotash, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit z. **Lonard Hoxha** në masën 100 %.

Blerësi, z. **Lonard Hoxha** është plotësisht dakord që të blejë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, masën prej 100% të kuotave të zotëruara nga shitësi në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare “**PRO-NARDI**” shpk.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi, ortakut **Z. Latif Hoxha** humbet pronësinë në masën 100%, të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë “**PRO-NARDI**” shpk, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi kuotat e shitura të shoqërisë, ndërsa blerësi, bëhet pronar në masën z. **Lonard Hoxha** në masën 100% të kuotave të shitura.

Shoqëria Tregtare “**PRO-NARDI**” shpk pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, do të ketë si Ortak te saj me pjesëmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:

- **Z. Lonard HOXHA** zotëron 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë “**PRO-NARDI**” shpk.. të barabartë me 1 (një) kuotë.

Shoqëria do të ketë administrator z. **Lonard HOXHA**.

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje kuotash të shoqërisë “**PRO-NARDI**” shpk. do të jetë shuma prej 100.000 (njëqind mijë) Lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të kuotave sipas Statutit të Shoqërisë. E gjitha shuma, për të cilën palët bien dakort të jetë e drejtë, i paguhet Shitësave nga Blerësi pa praninë e noterit.

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËS

Latif Hoxha

BLERËS

Lonard Hoxha

NOTERE

ROMINA SH. MELI

VENDIM
I
ASAMBLESE SE ORTAKËVE

Sot, më datë 06.07.2020, në selinë e Shoqërisë Tregtare “**PRO-NARDI**” Sh.p.k., në Tiranë, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Ortakut të vetëm të kësaj shoqërie, për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës, si më poshtë vijon:

1. Miratimi i shitjes së kuotave të zotëruara nga ortaku i vetëm i shoqërisë **Z.Latif HOXHA**, shtetas shqiptar, i biri i Hasis, lindur në Sorice, Dibër, i datelindjes 05.02.1974, me banim në Tiranë, i identifikuar me pasaportë me nr.BJ5343364 dhe nr.personal H40205099Q, madhor më zotësi të plotë për të vepruar:
2. Të ndryshme.

Në Asamble janë të pranishëm ortaku i shoqërisë Z. Latif Hoxha masa prej 100%.

Pasi u konstatua rregullsia e mbledhjes asambleja e ortakut, procedoi me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

- I. Ortaku i Shoqërisë Z. Latif Hoxha ka shprehur vullnetin e tij për të shitur 100% të kuotave që ai zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë. Pas realizimit të shitjes së kuotave nga ortaku i Shoqërisë, z. Lonard Hoxha, zoteron kapitalin themeltar të shoqërisë 100% të kapitalit.

Për sa më sipër, dhe në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, do të lidhet dhe kontrata përkatëse e shitblerjes së kuotave ndërmjet Shitësit ortak i vetëm Z. Latif Hoxha dhe Blerësit z. Lonard Hoxha.

Për pikën e parë të rendit të ditës, Ortaku i shoqërisë Z.Latif Hoxha vendosi shitjen e kuotave të shoqërisë përkatësisht në masën 100 %, kuota të zotëruara prej tij dhe blerjen e tyre nga z. Lonard Hoxha.

Pas diskutimit të rendit të ditës dhe duke mos patur pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, Asambleja e Ortakëve, në mbështetje me Statutin e Shoqërisë dhe ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,

VENDOSI:

1. Të miratojë shitjen e kuotave të shoqërisë “**PRO-NARDI**” Sh.p.k. në masën 100% të tyre në kapitalin themeltar, të cilat zotërohen nga ortaku i shoqërisë Z. Latif Hoxha. Kuotat do të blihen nga z. Lonard Hoxha në masën 100% të kuotave në kapitalin e shoqërisë.
2. Të ngarkojë administratorin ose persona të autorizuar prej tij me depozitimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
3. Adiminstratori i kesaj shoqerie do te behet z. Lonard Hoxha.

ORTAKU I SHOQËRISË
Z.Latif HOXHA





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-202007061523225
Data e Rezultatit të Kerkimit: 06.07.2020
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 3:02:32PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-617-803
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

PRO-NARDI SH.P.K



Elza Kelmehi